



Përshkrimi i Programit

1. Pse një Master në “Agronomi”

Të përgatisë specialistë me njohuri të thella në Agronomi, Hortikulturë dhe Mbrojtje të Bimëve.

Të përmirësojë aftësitë e studentëve në kuptimin e funksionimit të bimëve në kushte të ndryshme klimatike dhe situata stresi biotike dhe abiotike.

Të përgatisë studentët me kompetenca më të thella kërkimore.

2. Kompetencat e të diplomuarve

Të jenë në gjendje të aplikojnë teknologjitë moderne të kultivimit në kushte të ndryshme klimatike dhe tokësore.

Të jenë në gjendje të shpjegojnë sjelljen dhe reagimin biokimik dhe fiziologjik të bimëve në kushte normale dhe situata stresi.

Të vlerësojnë dhe përshtatin teknikat e kultivimit të bimëve me skenarët e ndryshimeve klimatike dhe kushtet lokale mjedisore.

Të aplikojnë praktikat më të mira për mbrojtjen dhe trajtimin pasvjeljes së produkteve bujqësore për të përmirësuar sigurinë ushqimore.

Të kryejnë kërkime të pavarura dhe bashkëpunuese për të adresuar sfidat aktuale dhe të reja në prodhimin e të korrave.

3. Punëdhënësit e mundshëm dhe/ose rruga e karrierës

Aktivitete mbështetëse bujqësore (p.sh. tregtarët e inputeve)

Sistemi këshillimor bujqësor (gjithashtu këshilltarë privatë)

Institucione bujqësore nën ombrellën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

OJQ-të

Sistemi Arsimor Profesional, UBT

4. Alumni të cilët mund të shërbejnë si shembull

Shkëlqim Karaj – Ka kryer master dhe Doktoratë në Gjermani. Aktualisht pronar dhe Menaxher i një ferme eksperimentale dhe tregëtar inputesh.

Griselda Kupe – Specialiste në Entin shtetëror të farave

Albert Rabeta – Prodhues fidanash

Shkelzen Malliku Tirane, Pronar dhe manaxher i njw ferme me vresht dhe prodhues vere

5. Si zbatohet ndërdisiplinariteti i programit?

12 ECTS nga shkencat ekonomike dhe sociale

18 ECTS nga shkencat natyrore

Gjatë zhvillimit të këtij programi është ndjekur parimi i qasjes ndërdisiplinore. Ky parim synon të integrojë metodat analitike dhe mjetet e disiplinave të ndryshme, duke prodhuar njohuri dhe zgjidhje të reja për problemet komplekse me ndikim real në prodhimin bujqësor, mjedisin dhe transferimin e teknologjisë, në kushtet e dinamikave të shpejta të sektorit bujqësor dhe rural. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, programi integron njohuri nga fushat e shkencave sociale, shkencave natyrore dhe shkencave teknike, duke ofruar një arsimim gjithëpërfshirës që përgatit studentët për të përballuar sfida komplekse në tregun real të punës.

6. Cilat programe Bachelor sugjerohen per kete Master

Bachelor në Bujqësi dhe Siguri Ushqimore

Me module plotësuese edhe studentë nga studime të tjera Bachelor brenda UBT-së ose edhe nga universitete të tjera